

REPUBLIKA E KOSOVËS

C.nr.2187/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Civile, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Latif Xhemaili, kryetar dhe gjyqtarët porotë Milazim Haxha dhe Basri Reçicaanëtarë, në prani të procesmbajtëses Zymrije Çunaku, në çështjen juridike të paditëses A.Z.nga fsh. Ll. - P., e martuar në M. tani me vendbanim në B. t. M., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Av. R.D.nga P., kundër të paditurës S.K.-M.nga fsh. Ll. - P., me vendbanim në Rr. “Xh.H.” M. ...-Ob-.... B-I. SH.P.K, kati ..., Banesa nr. ..., duke vendosur për çështjen e njohjes së atësisë, të mbajtur në prezencë të autorizuarit të paditëses dhe të paditurës, në seancën gjyqësore jo publike, të mbajtur më datë 26.02.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses A.Z.nga P. tanime banim në B. t. M.,e lindur me dt. ... në fsh. Ll. K. e P..

II. VERTETOHET se tani i ndjeri B. (A.) K. nga fshati Ll. - P., është i ati biologjik i paditëses A.Z., e lindur nga bashkësia jashtëmartesore me nënën e saj F.G..

III. Në bazë të këtij aktgjykimi,Komuna e Prishtines - Zyra e Ofiqarisë, do të bëjë ndërrimet në librin amzë të të lindurve, ku A.G.-Z. do të evidentohet si A.K.-Z., nga i ati B.K. dhe e ëma F.G..

IV.Shpenzimet e procedurës të shkaktuara në këtë rastkontestimor në tërësi I bartë pala paditëse.

A r s y e t i m

Paditësja A.Z., përmes të autorizuarit të saj Av. R.D.nga P., me dt. 28.09.2016 ka paraqitur në këtë gjykatë padi për njohjen e atësisë me tani të ndjerin-babain e saj B.K..

Në padi ka theksuar se e njejta ka lindur me dt. ... në fsh. Ll.-P., nga babai B.K. dhe e ëma F.G. e lindur më ... në fsh. M. K.e P.. Ka shtuar se babai i saj B.K., kishte filluar të bashkëjetoj me nënën e saj F.G., pasi që të njejtit i kishte vdekur bashkëshortja Sh.K., me të cilën kishte pasur një vajzë S. (B.) M. e lindur me dt.

Nga arsyet se prindërit e paditëses nuk kishin të lidhur kurorë në mes tyre, paditësja A.Z.ishte rexhistruar në librin amzë të të lindurve vetëm me emrin e nënës së saj F.G. dhe asnjëherë në certifikatën e lindjes nuk i ishte shënuar emri i babait B.K.. Ka shtuar se e paditura S.(B.) K. në Zyrën Noteriale me dt. 18.08.2016 me nr.LRP....., nën betim dhe në prezencën e dy dëshmitarëve, ka deklaruar se paditësja A.Z.është motra e saj nga babai B.K., e po ashtu këtë fakt e vërtetojnë edhe familjarët. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet padia dhe të vërtetohet se babai biologjik i paditëses është B.K..

Paditësja, përmes të autorizuarit të saj, në seancën e mbajtur me dt. 12.02.2018, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se e paditura S. (B.) M.-motra e paditëses nga babai edhe në përgjigje në padi të dt. 22.11.2017, por edhe në deklaratën e dhënë në Zyrën Noteriale të dt. 18.08.2016 LRP.nr....., nuk e ka kontestuar faktin se të njëjtat janë motra nga

babai i tyre B.K., mirëpo për arsye që prindërit e paditëses nuk kishin të lidhur kurorë në mes tyre, paditësja A.Z. ishte rexhistruar në librin amzë të të lindurve vetëm me emrin e nënës së saj F.G..

E paditura në përgjigje në padi, të dorëzuar në gjykatë më 22.11.2017, ka theksuar se paditësja A.Z. është motra e saj nga babai B.K. dhe njerka e saj përkatësisht e ëma e paditëses F.G.. Ka shtuar se kur motra e saj ka lindur me dt. ... e njejtja ka qenë ... vjeçare, andaj ka qenë mjaftë e pjekur për ta kuptuar se ka një motër nga babai me njerken e saj F.G..

Paditësja-motra e saj A.Z. ishte rexhistruar në librin amzë të të lindurve vetëm me emrin e nënës së saj F.G. dhe me mbiemërin e saj G., ngase prindërit e paditëses nuk kishin të lidhur kurorë në mes tyre, andaj edhe në çertifikatën e lindjes anjehërë nuk i ishte shënuar emri i babait B.K.. Thekson se është e gatshme të dëshmojë në gjykatë se babai biologjik i saj B.K. i lindur më ... dhe i vdekur më ... është edhe babai biologjik i tani paditëses A.G.Z. nga M. me banim në B. dhe se e paditura me paditësen kanë një baba të përbashkët biologjik. Nga të lartë cekurat, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet padia dhe të vërtetohet se babai biologjik i paditëses është B.K..

E paditura në seancën e mbajtur me dt. 12.02.2018, ka deklaruar se nuk është fare kontestuese se paditësja-A.Z. është motra e saj nga babai B.K., mirëpo në mungesë të kurorës së babait dhe nënës së paditëses, paditësja në mbiemrin e vajzërisë është rexhistruar me mbiemrin e nënës së saj G. dhe jo të babait K.. Po ashtu ka shtuar se gjatë kohës sa babai i tyre B.K. ka qenë gjallë, vajzave të tyre paditëses-A.Z. dhe të paditurës-S.M. iu ka ndarë pasurinë për gjysmë.

Gjykata për të vendosur drejtë në këtë çështje kontestimore, bëri administrimin e provave për të cilat i konsideroj si relevante për vendosjen e këtij rasti procedural, ashtu që lexoj padinë për njohjen e atësisë të dt. 28.09.2016, bëri shikim në ekstraktin nga rexhistri Qendror i Gjendjes Civile-fotokopje në emër të A.Z. të lëshuar me dt. ... në ZGJC - P., shikim në fotokopjen e çertifikatës së vdekjes të B.K. të dt.... e lëshuar nga ZGJC - Ll., P., shikim në çertifikatën e vdekjes të Sh.K. të dt.... e lëshuar nga ZGJC - Ll., P., shikim në çertifikatën e martesës në mes të B.Z. dhe A.G. me nr.ref.... të dt. ... e lëshuar nga ZGJC në M. dhe përgjigja në padi e palës së paditur me dt. 22.11.2017.

Pala paditëse përmes të autorizuarit të saj në fjalën e saj përfundimtare, ka deklaruar se edhe më tutje mbetet pranë theksimeve si më lartë, duke shtuar se edhe vet pala e paditur S. (B.) M. nuk e ka kontestuar se paditësja A.Z. është motra e saj. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të vendos si në petitum të padisë.

Shpenzimet e procedurës i kompenzon në tërësi edhe për të paditurën S. (B.) M..

Pala e paditur në fjalën e saj përfundimtare, ka deklaruar se paditësja A.Z. pa dyshim është motra e saj dhe se është e drejtë e të njejtës që në rexhistra përkatës t'i konstatohet se babai i saj biologjik është B.K. dhe nëna F.G..

Gjykata duke u bazuar në nënin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, provat e administruara i vlerësoj të gjitha një nga një dhe të gjitha së bashku e në varësi me njëra tjetrën.

Nga ekstrakti i rexhistrimit Qendror i Gjendjes Civile në emër të A.Z. të lëshuar me dt. ... në ZGJC - P., gjykata konstatoj se paditësja A.Z. ka lindur në Ll., me dt. ... nga nëna F.G., mirëpo në këtë dokument nuk është konstatuar asnjë e dhënë për të atin e saj.

Nga çertifikata e vdekjes e lëshuar me dt. ... nga ZGJC - Ll., P., gjykata konstatoj se B.K. i lindur me dt. ... nga i ati A.K., e ëma M.K. ka vdekur me dt.

Nga çertifikata e vdekjes e lëshuar me dt. ... nga ZGJC - Ll., P., gjykata konstatoj se Sh.K. e lindur me dt. ... nga i ati S.G., e ëma Z.G. ka vdekur me dt.

Nga certifikata e martesës e lëshuar me dt. ... me nr.ref.... nga ZGJC në M., gjykata konstatoj se B.Z. dhe A.G.-Z. kanë lidhur martesë me dt,

Gjykata pasi analizoi provat e administruara në kuptim të nenit 8 të LPK-së, vlerësoj se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe atë në bazë të gjendjes faktike e në pajtim me dispozitat e nenit 110 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen e Kosovës nr.2004/32, gjykata vërtetohet se tani i ndjeri B. (A.) K. ish nga fsh. Ll. – K. P., është i ati biologjik i patitëses A.G.-Z. e lindur me dt.... nga bashkësia jashtëmartesore me nënën e paditëses F.G..

Shpenzimet e procedurës të shkaktuara në këtë rastkontestimor në tërësi I bartë pala paditëse me pëlqimin e saj dhe në pajtim me nenin 450 të LPK-së.

Nga të lartë cekurat, gjykata në bazë të nenit 99, 101 e 110 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Familjen e Kosovës nr.2004/32 vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E THMELORE NË PRISHTINË
C.nr.2187/16, dt. 26.02.2018

KRYETARI I TRUPIT - GJYQTARI,

Latif Xhemali

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë, në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.